ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-2530-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Gjendjes Civile**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**"DataProgNet" SH.P.K.**
NUI	**810131318**
Adresa	**Rr. Qamil Ilazi,Nr.16**
Vendi	**Ferizaj**
Kodi postar	**70000**
Numri Telefonit	**049789662**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Naser Shabani**
Adresa elektronike	**naser.shabani@dataprognet-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**13.09.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Gjendjes Civile

Titulli i projektit "Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Gjendjes Civile"

Nr. i prokurimit: 214-23-2530-2-1-1

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

- **B58-Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues më datë 15.06.2023**
- **Njoftimi për dhënie të kontratës më datë 03.07.2023**
- **B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit te prokurimit më datë 28.08.2023**
- **Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Refuzimin e Kërkesës për Ri-Shqyrtim më datë 05.09.2023**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar ne kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPP-së.

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK përmes vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit përkundër që jemi rekomanduar për kontratë dhe nuk ka pasur asnjë ankesë në procedurë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke na diskriminuar si OE, për çka në vijim po i paraqesim faktet dhe argumentet për Ekspertin shqyrtues dhe Panelin Shqyrtues të OSHP-së:

Në njoftimin për vendimin e AK-së të datës 30.06.2023, ne jemi rekomanduar për kontratë nga AK si ofertues i vetëm i përgjegjshëm në raport me kriteret dhe kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës është 05.07.2023

Me datë 08.08.2023 AK përmes sistemit elektronik (eProkurimi) ka kërkuar vazhdimin e zgjatjes së validitetit të tenderit për 60 ditë kalendarike. Po në të njëjtën datë ne kemi

zgjatur validitetin e ofertës për 60 ditë kalendarike.

Çuditërisht me datë 28.08.2023 AK ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në lidhje me këtë aktivitet me arsyetimin si vijon: "*Arsye e anulimit te procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave te paragrafit 2 te nenin 26 te Ligjit te Prokurimit Publik*" . Arsyetimi i dhënë në AK është i pabazë, për faktin se neni 26, konkretisht paragrafi 2 rregullon përgjegjësitë e personave përgjegjës në raport me nënshkrimin e kontratave si veprime obliguese.

Me datë 29.08.2023 përmes sistemi eProkurimi kemi bërë kërkesë tek AK për qasje në dokumentacion, për të u njoftuar për arsyen e mos nënshkrimit të kontratës dhe anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Po në këtë datë na është lejuar qasja dhe jemi njoftuar nga u.d. Drejtori i Prokurimit të MPB-së me arsyeja e anulimit të kësaj procedure, të cilat arsye sipas LPP-ë nuk qëndrojnë.

Me datë 31.08.2023 përmes sistemi eProkurimi kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me datë 06.09.2023 nga AK kemi pranuar vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim me arsyen e njëjta si në vendimin për anulim, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave te paragrafit 2 te nenin 26 te Ligjit te Prokurimit Publik, duke i quajtur pretendimet tona në Kërkesën për rishqyrtim të pa bazuara. Po e potencojmë përsëri se Arsyetimi i dhënë nga AK është i pabazë, për faktin se neni 26, konkretisht paragrafi 2 rregullon përgjegjësitë e personave përgjegjës në raport me nënshkrimin e kontratave si veprime obliguese", në ketë fazë të prokurimit nuk ka kuptim të aplikohet, është krejtësisht i pabazuar dhe AK nuk ka pasur të drejtë fare me u thirr në ketë fazë të prokurimit në nenin 26 paragrafi 2.

Andaj po e ritheksojmë se sipas Ligjit për Prokurimin Publik arsyet për përfundimin e një aktiviteti të prokurimit janë rrethanat e përcaktuara në nenin 62, e në këtë rast asnjëri nga kriteret e këtij neni nuk janë përmbushur duke qenë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm me çmimin e ofruar në kuadër të paramasës buxhetore dhe nuk ka asnjë arsye ligjore për përfundimin e aktivitetet të prokurimit.

Duke e ditur rëndësinë që ka ky sistem për qytetarët Republikës së Kosovës, i klasifikuar si një ndër sistemet më të ndjeshme dhe të rëndësishme softuerike në kuadër të vendit me interes nacional, edhe pse nuk kemi pasur kontratë nga data 05.05.2023, deri në datën e dorëzimit të ankesë në OSHP me 13.09.2023 të gjitha kërkesat që na kanë arritur nga Zyrtarët e MPB-së për dhënie të përkrahjes për Sistemin Elektronik të Gjendjes Civile ju kemi përgjigjur dhe i kemi kryer në kohë, pasi që kemi të qartë rëndësinë e këtij sistemi për MPB-në dhe qytetarët e Republikës së Kosovës (në këtë mënyrë kemi vepruar çdo herë kur MPB nuk ka arritur të lidhë në kohë kontratën, nuk e kemi lënë asnjëherë pa përkrahje dhe nuk kemi kërkuar kompensime finaciare shtesë gjatë periudhave kur nuk kemi pasur kontratë).

Gjithashtu ju njoftojm se "Sistemin Elektronik të Gjendjes Civile" e ka zhvilluar dhe mirëmbajtur kompania DataProgNet SH.P.K.. Gjatë periudhës së zhvillimit, avancimit dhe mirëmbajtjes, nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga institucionet e IRK-së dhe as nga qytetarët, ku ju kemi përkushtuar në maksimum dhe seriozitet të lartë profesional. Nga MPB pas përfundimi të çdo periudhe të mirëmbajtjes 36 mujore posedojmë Referencë POZITIVE.

Stafi i kompanisë DataProgNet SH.P.K. ka punuar me përkushtim dhe seriozitet maksimal në zhvillimin, avancimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi kompleks, që lidhë (furnizon me të dhëna) mbi 100 sisteme tjera shtetërore, të gjitha këto lidhje/komunikime janë realizuar nga ne, ku asnjëherë nuk ka ndodhur që të mos realizohet ndonjë ndërlidhje me sistemet tjera duke dërguar çdo herë të dhëna me saktësi.

Sistemit Elektronik të Gjendjes Civile që është zhvilluar dhe implemtuar nga DataProgNet SH.P.K., ka rezultuar me sukses në plotësimin e njërit nga kriteret e kërkesave të liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, duke u bazuar nga faktet dhe argumentet e lartpërmendura, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të marrë vendim meritor, të anulojë vendimin e AK-së të datës 28.08.2023 dhe të detyrojë AK-në që të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës në lidhje me këtë procedurë, meqë është konstatuar së jemi ofertuesi i vetëm i përgjegjshme me çmimin më të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demi material i përgatitjes së ofertës si dhe dëmet tjera do te pasqyrohen pas një analize gjyqësore përfshirë kompensimi i fitimit të humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*